

JANI SOTA

**KONTRIBUTI I SHQIPËRISË NË PËRBALLIMIN
E EKSODIT NGA KOSOVA NË VITET
1998-1999***

Edhe pse në kujtesën tonë kolektive, historikun e shpërnguljeve masive të shqiptarëve nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi e lidhim me procesin e politikës shkombëtarizuese që ndiqnin qarqet drejtuese serbe të Beogradit ndaj shqiptarëve autoktonë të Kosovës, shpesh me data të papërcaktuara qartë, zana lla e kësaj dukurie është e hershme.

Po të mos llogarisim shpërnguljet nga sanxhaku i Nishit në vitet 1877-1878, vetëm në pjesën e parë të shek. XX, u vunë re tre periudha shpërnguljesh masive, pikërisht në vitet 1912-1915, 1919-1941 dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Ato u pasuan nga instalime vetëm në territorin e Shqipërisë, të dhjetëra mijë refugjatëve të ardhur në rrjedhën e Luftërave Ballkanike dhe të Luftës I Botërore, mandej, në fillim të viteve 20, kur erdhën nga Dibra e Madhe rreth 55 mijë veta¹, si të ikur të përkohshëm, por që një pjesë e madhe prej tyre qëndroi përgjithnjë në Shqipëri.

Në periudhën e dytë, kryesisht ndërmjet viteve 1927 dhe 1937 erdhën nga Jugosllavia edhe 11 mijë shqiptarë të tjerë², të cilët në pjesën më të madhe ishin nga Rrafshi i Dukagjinit dhe nga Kosova. Në këtë mënyrë, u ngulën në Shqipërinë e asaj kohe, një numër i konsiderueshëm prej atyre 60-70 mijë shqiptarëve³ të ardhur nga territori i Jugosllavisë, pa llogaritur qindra mijëra të tjerë, që u shpërndanë nëpër botë dhe u vendosën veçanërisht në Turqi (rreth 300 mijë persona)⁴.

* Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin Shkencor “Çlirimi i Kosovës”, organizuar në Prishtinë nga Instituti i Historisë me rastin e 10-vjetorit të Çlirimit të Kosovës, Prishtinë, 12 qershor 2009.

¹ Mark Tirta, “Migrime të shqiptarëve”, në: *Etnografia shqiptare*, nr. 18, Tiranë: 1999, f. 171.

² *Po aty*.

³ *Po aty*.

⁴ Marenglen Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, vëll.I, Tiranë: 2003, f. 405.

Periudha e tretë e shpërnguljeve i përket viteve 50-60', kur me angazhimin e veçantë të A.Rankoviçit u shpërndanë nëpër botë, rreth 400 mijë shqiptarë të tjerë⁵.

Periudha e fundit, e katërta, e shpërnguljes masive, një periudhë e shkurtër si kurrë më parë, është ajo e viteve 1998-1999, kur afërsisht mbi 800 mijë persona lanë vendin e tyre dhe u drejtuan për në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi etj., si dhe në vendet e tjera të Evropës (Gjermani, Itali, Zvicër etj.)⁶

Duke hedhur një vështrim në gjithë këtë hark kohor gati shekullor, konstatojmë se shteti shqiptar, ka qenë gjithmonë strehë e shumë prej të shpërngulurve me dhunë nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Por ndërsa në periudhën nga vitet 1912-1966, numri i të ardhurve në Shqipëri ishte 6-7 herë më i pakët se numri i të vendosurve në Turqi, në etapën e fundit që i përket viteve 1998-1999, Shqipëria ishte, pa dyshim, jo vetëm pritësja e parë e të dëbuarve nga vatrat e tyre, por ajo akomodoi rreth 65-70% të numrit të përgjithshëm të rreth 800 mijë shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova⁷.

Duke analizuar kronologjinë e ngjarjeve për etapën 1998-1999 konstatojmë se brenda saj mund të përcaktohen dy faza.

Faza e parë fillon nga 2 shkurti 1998 dhe zgjatet deri në 28 janar 1999. Për shkak të luftimeve në Kosovë midis Armatës së Millosheviçit dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), qindra mijëra shqiptarë për t'i shpëtuar terrorit serb braktisën shtëpitë e tyre dhe u çvendosën në qendra të tjera banimi ose në male. Rreth 100 mijë vetë, dolën jashtë Kosovës dhe deri në nëntor 1988, 15.929 ose 15,9% të larguarve u strehuan në Shqipëri⁸.

Duke analizuar listat mujore të të ardhurve të regjistruar për vitin 1998, rezulton se fluksi më i madh i të ardhurve nga Kosova në Shqipëri i përket periudhës qershor-tetor, gjatë të cilës u akomoduan 1694 familje me 8470 persona, prej të cilëve 4935 femra⁹.

Faza e dytë, përfshin segmentin kohor 24 mars -14 qershor 1999 dhe lidhet me fillimin e intervenimit të NATO-s në Kosovë deri në kapitullimin e armatës serbe dhe nënshkrimin e paqes në Kumanovë (Maqedoni). Në këtë fazë numri i të depërtuarve me dhunë ekstreme jashtë Kosovës u rrit edhe me rreth 700 mijë shqiptarë të tjerë¹⁰.

⁵ *Po aty*, vëll. II, Tiranë: 2003, f. 261.

⁶ *International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies* (më tej: *International Federation.....*), *Refugees from Yugoslavia*, 9 qershor 1999, f. 1.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Arkivi i Kryqit të Kuq Shqiptar*. Fondi i ndihmave për kosovarët, viti 1928, dosja 2, f.3.

¹⁰ *International Federation.....*, f. 1.

Qoftë shpejtësia dhe dhuna e padëgjuar më parë, me të cilën u krye goditja e armatës së Milosheviçit mbi shqiptarët e Kosovës, qoftë ndërgjegjësimi i tyre se vend më mikpritës se shteti amë nuk mund të ketë, përcaktoi që rreth 458 mijë, ndër 800 mijë të shpërngulurit e viteve 1998-1999 të hynin dhe të vendoseshin përkohësisht në territorin e shtetit shqiptar¹¹. Madje, sipas të dhënave të publikuara nga komisarati i lartë i OKB-së për refugjatët (UNHCR), (që ka monitoruar situatën nga 19 marsi 1999, kur u largua Misioni verifikues i OSBE-së për Kosovën) 221 mijë të tjerë u vendosën në Maqedoni dhe 62 mijë në Mal të Zi¹².

Sipas të dhënave të International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, Refugees from Yugoslavia, të cituar më sipër në Bosnjë-Hercegovinë u strehuan 18 mijë vetë, kurse në 11 vende të tjera përkatësisht në Austri 161 vetë, në Belgjikë 340, në Kroaci 88, në Francë 348, në Gjermani 9296, në Islandë 23, në Izrael 106, në Norvegji 1104, në Poloni 60, në Zvicër 33 dhe në Turqi 3692 persona¹³.

Fluksi i madh i refugjatëve në drejtim të Shqipërisë dhe shteteve fqinje si Maqedonia dhe Mali i Zi, i dedikohet jo vetëm afërsisë gjeografike por edhe pranisë masive të elementit shqiptar në këto shtete.

Interesimi i veçantë i shtetit shqiptar, për të lehtësuar sadopak dhimbjen e bashkëkombasve nga Kosova pasqyrohet qartë në një varg masash me natyrë juridike dhe praktike, që u ndërmoren nga autoritetet shqiptare qendrore dhe lokale, të cilat evidentohen gjatë periudhës 1989-1999.

Kështu qeveria shqiptare e kryesuar nga Pandeli Majko, duke parë fluksin e refugjatëve gjithmonë dhe në rritje, ngriti menjëherë "...Grupet e punës që kontrollojnë situatën:

1. Grup pune në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 28 mars për t'i ardhur në ndihmë të gjithë të shpërngulurve me dhunë nga Kosova.

2. Grup pune që do të operojnë në zonën verilindore, që do të ndjekë evakuimin e popullsisë shqiptare nga Kosova në drejtim të qendrave pritëse të ngritura posaçërisht në prefekturat e vendit.

3. Grup pune që do të merrej me hartimin dhe vëzhgimin e planit ditor të dërgimit të mjeteve të transportit për në zonat verilindore. Ky plan do t'u komunikohet të gjithë prefekturave dhe bashkive për t'u zbatuar.

4. Grup pune për vëzhgimin e situatës së transportit me autobus nga rrethi i Kukësit. Grup pune për njoftimin në media dhe për sensibilizimin e të gjithë

¹¹ *Po aty.*

¹² *Po aty; UNHCR, Field Office Vlora, 1 qershor 1999, f. 1; Shih edhe M. Verli, vep. e për. vëll. II, f. 200.*

¹³ *International Federation..., f. 2.*

transportuesve për të ndihmuar në evakuimin e popullsisë shqiptare të Kosovës”¹⁴.

Problemet që duhet të zgjidheshin me shpejtësi nga shteti shqiptar ishin ato që lidheshin me strehimin, ushqimet dhe nevojën e shpërndarjes së refugjatëve në zonat e tjera të vendit. Mbarimi i kapaciteteve të prefekturës së Kukësit, e detyroi Qeverinë Shqiptare që të hartonte planin provizor për shpërndarjen e të ardhurve nëpër rrethet e vendit. Burime të ministrisë së Pushtetit Lokal konfirmonin, se: "... deri tani janë plani kuar shifrat e shpërndarjes për 11 rrethe të vendit. Me rritjen e fluksit të të ardhurve, këto shifra do të rishikohen". Kështu, ishte llogaritur, që në Prefekturën e Fierit të akomodoheshin 2.500 veta, në Tiranë 3000, në Shkodër 2000, në Vlorë 2000, në Berat 4000, etj.¹⁵

Gjithashtu Kryeministri Majko në takimin me ambasadorët dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar për të ndihmuar në përballimin e krizës. Përgjigja ka qenë e menjëhershme. Zyra e UNHCR-rë konfirmoi, se: "...vende si Gjermania, Zvicra, SHBA-ja, Turqia, Norvegjia, Britania, por edhe Greqia e Italia po ofrojnë mbështetjen për operacionin humanitar të pritjes së refugjatëve nga Kosova”¹⁶. Kështu, sipas të dhënave të kësaj gazete, me rihapjen e aeroportit të Rinasit "... nga data 30 mars janë ulur çdo ditë dhjetë avionë me ndihma ushqimore, veshmbathje, medikamente si dhe pajisje të tjera të nevojshme për strehim”¹⁷.

Nga dita në ditë, si pasojë e rritjes së dhunës dhe terrorit nga forcat paramilitare ushtarake e policore ndaj popullsisë kosovare u rrit me shifra dramatike fluksi ditor i ardhjes së tyre në Shqipëri. Ajo ishte disa herë më e lartë se numri i të evakuarve për në destinacionet e përcaktuara në rrethe të ndryshme të vendit. Për të evakuarit nga Prefektura e Kukësit, qeveria shqiptare vendosi "...vënien në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, të të gjithë shoferëve të Ministrive dhe Institucioneve Qendrore, të cilët zotëronin dëshmi aftësie për drejtimin e automjeteve të tonazhit të lartë”¹⁸.

Gjithashtu, nën kujdesin e shtetit shqiptar, por dhe financimit nga donatorë të huaj, u bë e mundur ngritja e 22 kampingjeve dhe qendra kolektive në territorin e Shqipërisë (12 qendra kolektive dhe 10 kampingje) ku u akomoduan 178.613 persona (95.282 në qendra kolektive dhe 83.331 në

¹⁴ *Shekulli*, 30 mars 1999.

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, 20 prill 1999.

¹⁸ *Po aty*, 30 mars 1999.

kampingje) ose 38% e numrit të përgjithshëm të të ardhurve (Shih hartën bashkangjitur artikullit)¹⁹.

**Numri i të ardhurve kosovarë në Shqipëri
(19 mars - 9 qershor 1999)²⁰**

Tab. 2

Prefektura	Numri i kosovarëve të sistemuar			Gjithsej
	Sistemuar në familje	Sistemuar në kampingje	Sistemuar në qendra kolektive	
Kukës	37 400	30 615	2 384	70 399
Dibër	6 378	-	8 365	14 743
Elbasan	13 912	6 650	10 296	30 858
Shkodër	31 399	4 600	8 521	44 520
Lezhë	16 871	3 982	12 071	32 924
Durrës	47 902	13 121	8 049	69 072
Tiranë	95 707	12 620	16 056	124 383
Fier	14 722	3 500	6 812	25 034
Berat	3 177	0	4 777	7 954
Vlorë	7 369	5 153	8 436	20 958
Korçë	4 575	2 800	7 488	14 863
Gjirokastrë	856	290	2 027	3 173
Totali	280 268	83 331	95 282	458 881

Sipas të dhënave që lidhen me procesin e akomodimit të të ardhurve nga Kosova në Shqipëri, rezulton se numrin më të madh të akomodimeve e siguroi Prefektura e Tiranës, në të cilën u vendosën 124.383 veta. Rreth 80% e tyre u sistemuan në familjet kryeqytetase dhe të rrethinave²¹.

Një peshë të madhe, natyrisht e mbajti edhe Prefektura e Kukësit, që ishte edhe stacioni i parë i vendqëndrimit për të ardhurit nga Kosova prej nga mandej niste shpërndarja drejt destinacioneve të tjera të përcaktuara për akomodim. Në këtë prefekturë u akomoduan 70.399 persona, çka e rendit atë në vendin e dytë në shkallë vendi²². Pas këtyre dy prefekturave vinin në radhë Prefektura e Durrësit me 69.072 persona të akomoduar, Prefektura e Shkodrës me 94.520 persona, Prefektura e Lezhës me 32.924 persona, Prefektura e Elbasanit me 30.858 persona, Prefektura e Fierit me 25.054 persona etj. Pesha që mbajtën prefekturat e Tiranës, Kukësit dhe Durrësit, në të cilat u akomoduan 263854

¹⁹ *International Federation ...*, f.1.

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Po aty.*

²² *Po aty.*

vetë, ose 57,4% e të ardhurave në shkallë republike, tregon kontributin e tyre të veçantë në procesin e akomodimit²³.

E ritheksoj, se përballimi me sukses i situatës emergjente në të cilën kaloi Shqipëria gjatë periudhës së eksodit të madh, i dedikohet disponimit të "shtetit amë" për bashkëkombësit, përfshi këtu strukturat zyrtare e jo zyrtare. Natyrisht i dedikohet edhe mikpritjes dhe bujarisë së popullsisë i cili ishte edhe çelësi i suksesit dhe i zgjidhjes së shumë problemeve, që kishin të bënin me akomodimin e të ardhurve nga Kosova, të vendosur pranë familjeve vendase, kampingjeve dhe qendrave kolektive në Shqipëri. Përqindja e konsiderueshme e të vendosurve nëpër familje, është dëshmia më e mirë për mikpritjen vëllazërore të vendasve, për bashkëkombësit në fatkeqësi të ardhur nga Kosova.

Pas largimit të ushtrisë serbe nga Kosova, në qershor të vitit 1999, shumica e të ardhurve u rikthyen në vendbanimet e tyre në Kosovë.

Organizimi i rikthimit të shpejtë e sa më të lehtë, është një çështje më vete, por para se të ndalemi në këtë çështje do të dëshironim të përmendim një kthim të një lloji të veçantë, për të cilin kemi disa të dhëna, që i takojnë muajve prill-maj të vitit 1999. Në këtë kohë me tragetet që vinin nga brigjet e Italisë mbërritën në Shqipëri 2279 kosovarë. Sipas deklaratave të tyre ata synonin "... të mbërrijnë sa më parë në Kosovë dhe të bashkohen me forcat e UÇK"²⁴. Vetëm me tragetet "Skënderbeu" dhe "Adriatika" mbërritën me këtë synim 250 vetë. Të ardhurit ishin të moshave 20-40 vjeç dhe ishin nisur nga Gjermania, Zvicra, Belgjika dhe shtete të tjera evropiane, me itinerar Itali-Vlorë ose Durrës dhe destinacion përfundimtar Kosovën²⁵.

Në kuadër të kthimit të të dëbuarve pas përfundimit të luftës në Kosovë, do të përmendim se më 15 qershor 1999 Intrenacional Rescue Committee në bashkëpunim me institucionet e tjera si: UNICEF, NATO, Catholic Relief Services (CRS), Humanitarian Information Center (HIC), CARE International etj, bënë të mundur botimin e parë të librit "*Informator për familjet kosovare*"²⁶. Ky libër i posaçëm kishte për qëllim informimin se ku ndodheshin të afërmit dhe familjarët e të 19 658 kryefamiljarëve kosovarë të shpërndarë në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe 20 shtete të tjera²⁷. Duke llogaritur se secili nga kryefamiljarët kishte me vete afërsisht 6 anëtarë të familjes, llogaritej se libri përmbante shënime për afërsisht 120 000 të larguar jashtë Kosovës²⁸.

²³ Po aty.

²⁴ Gazeta Myzeqeja, Fier, 2 qershor 1999.

²⁵ Po aty.

²⁶ International Rescue Committee, *Informator për familjet kosovare*, botimi i parë, 15 qershor 1999.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

Gjithashtu, të dhënat nga libri ishin në disponim të faqes së internetit në adresën: www.kosovarfamily.nder.org²⁹. Me kthimin e njerëzve në Kosovë, ata gjithashtu mund të jepeshin të dhënat e tyre të reja për botime të mëtejshme të librit.

Me mbarimin e luftës dhe hyrjen e trupave ushtarake të NATO-s në Kosovë u ndërmorën edhe hapa konkrete për zbatimin e planit për rikthimin e kosovarëve në shtëpitë e tyre. Për këtë qëllim NATO-ja në planin e saj parashikonte: "... që afro 150 mijë kosovarë të kthehen me mjetet e tyre, - theksonte nënkoneli Riegel, - pjesa që mbetet do të transportohet nga ne"³⁰.

Operacioni ishte konceptuar në tre faza, të cilat filluan në mënyrë të njëkohshme:³¹

Faza e parë: Përgatitja, e cila kishte të bënte me krijimin e tre qendrave shqiptare në Mjedë, Kukës dhe Korçë nga UNHCR-ja, e ndihmuar nga qeveria shqiptare dhe AFOR-i Gjithashtu, ajo krijoi edhe qendrat tranzitore në brendësi të Kosovës si: në Prizren, Prishtinë, Gjilan, Rahovec, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë. Në bashkëpunim me KFOR-in u regjistruan refugjatet e shtatë zonave, të Mitrovicës, Prishtinës, Gjilanit, Rahovecit, Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës. Veç kësaj AFOR-i ndihmoi UNCHR-në në zhvillimin e një programi të kuptueshëm informacioni për të riatdhesuarit kosovarë.

Faza e dytë: Fillimi i lëvizjes, ku UNCHR-ja bëri të gjitha përpjekjet për organizimin dhe drejtimin e qendrat tranzitore në Korçë, Mjedë dhe në Kukës. Ajo gjithashtu, u mor edhe me regjistrimin e refugjatëve sipas shtatë zonave që përmendëm më lart.

Faza e tretë: Lëvizja drejt Kosovës, që u realizua nga Grupi i Menaxhimit të Emergjencës në bashkëpunim me AFOR-in, të cilët koordinuan veprimet për lëvizjen e sigurt të refugjatëve, të bagazheve dhe, në disa raste, pse jo edhe të ushqimit në karvanet e kombinuara, nga tre palët, UNCHR-ja, AFOR-i dhe nga qeveria shqiptare, në segmentin nga Mjeda dhe Kukësi në drejtim të pikave tranzitore të Kosovës.

Rol të rëndësishëm në procesin e kthimit do të luante edhe transporti ajror, i cili u bë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me forcat e përcaktuara në këtë detyrë, AFOR-n dhe qendrën e kontrollit të operacionit ajror të KFOR-it.

Dëshira e madhe për t'u rikthyer në atdhe, bëri që të shfaqej fenomeni i kthimit vullnetar në mënyre masive të refugjateve, pa marrë parasysh udhëzimet e UNCHR-s dhe qeverisë shqiptare për një rikthim të organizuar. Kështu, në sajë të organizimit të organeve të pushtetit lokal, brenda dhjetë ditësh u larguan me dëshirën e tyre rreth 150.000 refugjatë, kurse pjesa tjetër prej 230.000 vetash u transportua nga NATO-ja gjatë muajit qershor. Nga ky kontigjent,

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Shekulli*, 22 qershor 1999.

³¹ *Po aty*.

55% e përbënin banorët e Prishtinës dhe të rrethinave të saj, 11% ato të Gjakovës, 11% banorët e Mitrovicës dhe 13% zona e Gjilanit dhe rrethinat e tij³². Kurse pjesa tjetër e mbetur në Shqipëri, u largua gradualisht gjatë muajve në vazhdim të vitit 1999.

Në përfundim të kësaj kumtese mund të themi se ai moment i dhimbshëm i përballuar së bashku, saldoi si kurrë më parë e ngriti në një nivel të ri, raportet midis bashkëkombësve, të ndarë për një shekull, nga ku ri politik i caktuar arbitrarisht nga Fuqitë e Mëdha të asaj kohe.

10 vitet që kanë kaluar, dëshmojnë se asaj të keqeje në ditëm t'i vjelim të mirën. Shqipëria dhe Kosova tani janë shumë pranë në çdo pikëpamje, por e rëndësishme është se shpirtërisht janë një.

³² *International Federation ...*, 2 korrik 1999, f.3.